

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-97/2014**

**Prishtinë, 19 Shkurt 2016**

Në çështjen juridike të:

**Z. D.**

*Pala ankuese*

Kundër.

**G. E.**

**H.E.**

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini si kryetar i kolegjit, dhe Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov si anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA33769), të datës 11 qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 Shkurt 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesat e Z. S. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013, të datës 11 qershor 2013, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013, i datës 11 qershor 2013, konfirmohet sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA33769.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 22 maj 2007, Z. S. D. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të regjistruar me numër KPA33769, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave me numër 474 dhe 475 me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.43.44 m<sup>2</sup>, në Milloshevë, Obiliq Vise Sela, të regjistruar në listën poseduese me numër 75 (tash e tutje: prona e kërkuar).
2. Pala ankuese ka pohuar se është bashkëpronar i 1/7 pjesë ideale të pronës së kërkuar. Të drejtat pronësore i ka fituar përmes trashëgimisë. Sipas palës përgjegjëse në ankesë humbja e posedimit ka ndodhur më 19 qershor 1999.
3. Pala ankuese bashkë me kërkesën ka paraqitur në AKP *ndër tjera*:
  - Kopjen e fletës së pjesshme poseduese nr. 75, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Komuna e Obiliqit, më 26 janar 2004, e cila në mes tjera rendit palën ankuese si bartës të drejtës pronësore (BDP) i 1/7 pjesë ideale të pronës së kërkuar;
  - Kopjen e planit të 26 janarit 2004 e cila e rendit palën ankuese si BDP të pronës së kërkuar;
  - Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë të marrë në lëndën Nr.O.nr 88/81 të datës 20 prill 1981 e cila, në mes tjerash, e shpall palën ankuese si njërin nga trashëgimtarët e të ndjerit J. D.;
  - Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë të marrë në lëndën Nr.O.nr 89/81 të datës 20 prill 1981 e cila, në mes tjerash, e shpall palën ankuese si njërin nga trashëgimtarët e të ndjerit S. D.;
  - Deklaratën e palës ankuese të datës 08.09.2011 sipas së cilës as vetë pala ankuese e as vëllezërit e tij M., U., M., A., nëna e tij A. dhe motra e tij D. V., nuk e kanë shitur pronën e kërkuar të regjistruar në listën poseduese 75.
4. Më 26 tetor 2007 AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës: tokë e punuar në Obiliq. Prona është gjetur e zaptuar nga by G. E., i cili ishte i pranishëm në pronë ka deklaruar se kërkon të drejtën ligjore të saj dhe ka nënshkruar njoftimin mbi pjesëmarrjen. G.E. megjithatë ka deklaruar se nuk ka dashur të paraqesë kërkesë në AKP.

5. Më 5 mars 2010 AKP-ja ka lokalizuar pronën në bazë të koordinatave të GPS-së dhe ortofotos.
6. Më 21 qershor 2011 A. E. ka paraqitur përgjigje në kërkesë, në të cilën ka deklaruar se ngastrat i ka blerë më 30 nëntor 1995 nga M. D.. Ai shtoi se në atë rast ia kishte dhënë shitësit shumën e plotë të çmimit të shitjes.
7. Bashkë me përgjigjen pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur në AKP *ndër tjera*:
  - Kopjen e kontratës mbi shitblerjen e pronës së paluajtshme, të lidhur më 30 nëntor 1995 në mes të M. D., i cili ka deklaruar se është pronari ekskluziv i ngastrës 475, të regjistruar në listën poseduese 110 Komuna Kadastrale Milloshevë, të trashëguar nga vëllai i tij i ndjerë, si shitës dhe A. E. si blerës;
  - Kopjen e listës poseduese nr. 110 të datës 3 nëntor 1994 e cila rendit S. J. D.si BDP të ngastrës nr. 475;
  - Kopjen e listës poseduese nr. 75 të datës 3 nëntor 1994 e cila rendit S. T. D.si BDP të ngastrës nr. 474.
8. Pala ankuese ka paraqitur përgjigje ndaj përgjigjes së palës përgjegjëse në ankesë me pretendim se kontrata mbi shitblerjen e paraqitur nga pala përgjegjëse në ankesë ka rezultuar nga vepra penale. Më tutje ai ka deklaruar se vëllai i tij M. D. asnjëherë nuk ka lidhur kontratë shitblerjeje me A. E., veçanërisht pasi që nuk ka mundur të pranohet si pronar ekskluziv i tërë ngastrës. Ai po ashtu ka shtuar se vëllait të tij i kishin vjedhur letërnjoftimin. Letërnjoftimi i cili është përmendur në kontratë ka qenë i lëshuar pasi ishte nënshkruar kontrata e pretenduar. Përveç kësaj, sipas tij motra e tij Desanka Vujovic ka shfrytëzuar pronën deri në vitin 1999, kur është detyruar të ikë nga Kosova.
9. Më 11 qershor 2013, KKPK-ja me vendimin KPCC/D/A/204/2013 (para. 21-23) ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. Në arsyetim Komisioni ka shënuar se nuk ishte kontestuese në mes palëve se familja e palës përgjegjëse në ankesë kishte në posedim të dy pronat e kërkuara prej vitit 1995. Komisioni më tutje konstatoi se pala përgjegjëse në ankesë ka zaptuar ngastrën 475 në bazë të marrëveshjes joformale të bërë me vëllain e palës ankuese si bashkëpronar, dhe se ka zaptuar ngastrën 474 pa asnjë bazë ligjore. Megjithatë, sipas Komisionit, pasi pala ankuese kishte humbur posedimin e pronave të kërkuara më parë në vitin 1995 dhe se humbja e pretenduar e posedimit nuk përfshin rrethana të lidhura drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999, kërkesa është jashtë mandatit të Komisionit dhe është hedhur poshtë.
10. Më 23 janar 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Vendimi i është dorëzuar A. E. më 5 nëntor 2013 – nënshkrimi i pranuesit në fletëpranim është i palexueshëm.
11. Më 20 shkurt 2014, Ž. D. ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi.

### **Pretendimet e palëve**

12. Pala ankuese Ž. D. kërkon nga Gjykata Supreme ta pranojë ankesën dhe ta konfirmojë se ai është i autorizuar për ta ri-poseduar pronën. Pala ankuese pretendon se Komisioni ka vërtetuar faktet në mënyrë jo të plotë dhe ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale. Ai deklaroi se sipas tij faktet e paraqitura në vendim nuk janë të sakta. Pala ankuese mohoi të ketë thënë se familja e palës përgjegjëse në ankesë po e shfrytëzonte papenguar pronën e kërkuar që nga viti 1995. Këtë rrethanë e konfirmuan anëtarët e familjes së tij: D. D. dhe Ž. D., si dhe fqinjët e tij. Duke marrë parasysh se nënshkrimi i M. D. ishte falsifikuar ai kërkon të emërohet një ekspert për ta vërtetuar këtë çështje.
13. Ankesa e palës ankuese i është dorëzuar G. E. dhe I. E. më 10 dhjetor 2015. Më 11 dhjetor 2015, në përgjigje të urdhrit të Gjykatës Supreme të datës 12 nëntor 2015, I. E. paraqiti certifikatën e vdekjes së A. E. duke deklaruar se ky i fundit kishte vdekur më 23 prill 2013, si dhe kopjen e vendimit mbi trashëgiminë të palës së ndjerë përgjegjëse në ankesë, të lëshuar nga noteri publik N.R. më 30 qershor 2014.

### **Arsyetimi ligjor**

14. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të dokumenteve të mbledhura në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të vendimit të apeluar dhe të parashtrësve të të dyja palëve, gjen se ankesa është e pabazuar. Gjykata Supreme e Kosovës mendon se gjendja faktike është vërtetuar plotësisht dhe saktë si dhe e drejta materiale dhe procedurale janë aplikuar drejt në vendimin e apeluar të KKPK-së. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
15. Kontesti në mes të palëve buron nga kontrata e pretenduar e shitblerjes e vitit 1995 për ngastrën numër 474. Pala ankuese pohon se faktet e paraqitura në arsyetimin e vendimit nuk ishin të sakta. Ai nuk është pajtuar me deklaratën se rrethana lidhur me posedimin e pronës se kërkuar daton që nga viti 1995. Gjykata Supreme vëren se pala ankuese disa herë e ka ndryshuar deklaratën e tij përkitazi me atë se kush ishte në posedim të pronës së kërkuar gjatë konfliktit të viteve 1998/99 në Kosovë. Në fund, gjatë bisedës me përfaqësuesin e AKP-së më 4 prill 2013 pala ankuese pranoi se vëllai i tij ia kishte shitur ngastrën me numër 475 A. E. në vitin 1995, porse këtë e kishte bërë pa lejen e tij. Sa i përket ngastrës 474, ai sqaroi se nuk ishte shfrytëzuar nga vëllezërit e tij deri më 1999 pasi vëllai i tij U. D. jetonte në Nish (Republikën e Serbisë) dhe vëllai tjetër A. D. kishte vdekur shumë kohë më parë. Më tutje ai sqaroi se motra e tij ka jetuar në Kosovë deri më 1999, por nuk e ka shfrytëzuar ngastrën. Vetë pala ankuese, në bazë të bisedës së datës 25 mars 2013, nuk ka jetuar gjatë në Kosovë dhe nuk i ka shfrytëzuar vetë asnjëherë këto dy ngastra. Pas pranimit të vendimit pala ankuese edhe një herë e ndryshoi deklaratën dhe deklaroi se ngastrat

- në fakt shfrytëzoheshin nga familja D. Gjykata Supreme është e mendimit se deklaratat nuk janë koherente me njëra tjetrën, dhe janë në kundërshtim me njëra tjetre. Sipas mendimit të gjykatës deklarata e dhënë gjatë bisedës me përfaqësuesit e Sekretariatit Ekzekutiv janë të besueshëm dhe duket të merren parasysh në marrjen e vendimit mbi ankesën. Për më shumë, kjo deklaratë është koherente me qëndrimin e palës përgjegjëse. Prandaj, Gjykata Supreme nxjerr përfundim, siç ka vërtetuar saktë Komisioni, se kontesti i referohet humbjes potenciale të posedimit të pronës së kërkuar, tanimë në vitin 1995.
16. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079 KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe të kërkesave për të drejtën pronësore “të lidhura drejtpërdrejt ose si rezultat i konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.” Kjo do të thotë se fushëveprimi i ekzaminimit të AKP-së është verifikimi i elementeve në vijim: kush ishte në posedim të pronës së kërkuar para 27 shkurtit 1998, kush është në posedim të saj tani, kur dhe për ç ‘arsye është humbur posedimi gjatë periudhës kohore në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Nëse komisioni verifikon se posedimi e pronës së kërkuar është humbur para ose pas datave të përmendura më lart, ose e humbja e posedimit nuk ka të bëjë me konfliktin, atëherë komisioni e hedh poshtë kërkesën në bazë të nenit 11.4(b) të Ligjit Nr. 03/L-079.
  17. Pas arritjes së përfundimit se as pala ankuese, e as vëllezërit e motra e tij nuk kanë shfrytëzuar pronën e kërkuar pas vitit 1995, Gjykata Supreme konsideron se kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së. Çështja se a mund të ketë ndonjë efekt juridik kontrata e shitblerjes e lidhur në mes vëllait të palës ankuese më 1995 nuk qon peshë në rezultatin e procedurën para gjykatës, pasi pretendimet e parashtruara nga palët i takojnë kategorisë së kontesteve të cilat duhet të vendosen nga gjykata kompetente civile. Shqyrtimi i elementeve të tjera që i referohen fitimit të së drejtës pronësore bie jashtë juridiksionit të KKPK-së.
  18. Rrjedhimisht, pasi pala ankuese nuk ka vërtetuar se e kishte në posedim pronën e kërkuar gjatë periudhën kohore në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999, se kishte humbur posedimin e saj gjatë asaj periudhe për shkak të konfliktit, Gjykata Supreme konsideron se ankesa refuzohet si e pabazuar.
  19. Përveç kësaj, vlen të përmendet se sipas nenit 12.11 të Ligjit Nr. 03/L-079 Gjykata Supreme nuk i pranon e as nuk i shqyrton faktet dhe provat e reja materiale të paraqitura nga cilado palë në ankesë, përveç nëse demonstron se faktet dhe provat e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palët në fjalë. Megjithatë, provat e paraqitura në ankesë nga pala ankuese nuk mund të konsiderohen si të paafatshme.
  20. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje nenin 13.3.(a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe me nenin 195, paragrafin 1.e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë juridike**

21. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referent e EULEX-it**